

Në bazë të nenit 7, alineja 9 nga Ligji për themelimin të Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural e publikon këtë:

THIRRJE PUBLIKE nr. 10/2018
për parashtrim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare në zhvillimin rural për vitin 2018

I. LËNDA E SHPALLJES

Lënda e kësaj e shpallje është shpërndarja e mbështetjes financiare për masën në vijim:

Kodi i masës	Emri i masës	Shpenzimet e pranueshme
2	Subvencionimi i shkallës së interesit	Ndihma në shumën prej 50% nga shkalla e interesit për nivelin vjetor për periudhën deri 10 vjet

II. TË DREJTË NË SHFRYTËZIM TË MJETEVE

Të drejtë në shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjekte	Masa
Shfrytëzues të ndihmës për subvencionim të shkallës së interesit janë subjektet fizik dhe juridik shfrytëzues të mjeteve financiare nga instrumenti për ndihmë paraqasëse në bujqësi dhe zhvillimin rural nga Unioni Evropian	Masa 2

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Ndihma është e paraparë për kreditë të cilët kanë kamatë vjetore në shumën prej 8% në nivel vjetor, të cilat janë të vendosura nga bankat dhe shtëpitë e kursit me leje për punë nga Banka kombëtare e Republikës së Maqedonisë për periudhë deri më 10 vjet edhe atë për investime të cilat janë të financuara nga instrumenti për ndihmë paraqasëse në bujqësi dhe zhvillim rural nga Unioni Evropian (IPARD) dhe të njëjtat nuk janë më të larta se 500.000 euro në kundërvlerë të denarëve sipas kursit të mesëm të Bankës kombëtare të Republikës së Maqedonisë të përcaktuar në ditën e lidhjes së marrëveshjes për kredi.

Ndihma është në shumën prej 50% nga shuma e shkallës së interesit në nivel vjetor. Shuma e ndihmës mund të jetë edhe më e lartë se 50% në pajtim me nenin 94 paragrafi (2) nga Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesat mund të parashtrihen në mënyrë elektronike pas regjistrimit të realizuar në e-baranje.ipardpa.gov.mk

Një kërkesë mund të parashtrijë vetëm një kërkesë për një masë ose më së shumti 2 kërkesa individuale për masë të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat tjera nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018.

Të drejtë në shfrytëzim të ndihmës financiare do të kenë shfrytëzuesit e mjeteve financiare nga instrumenti për ndihmë paraqasëse në bujqësi dhe zhvillimin rural nga Unioni Evropian (IPARD), të cilët kanë nënshkruar marrëveshje pas përfundimit të thirrjes së fundit publike për subvencionim të shkallës së interesit, gjegjësisht pas 25.12.2016.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/18, 100/18, 127/18, 172/18 dhe 193/18)
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural, neni 98-a ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17 dhe 83/18).

Kërkesit e mbështetjes financiare është e nevojshme të krijojnë kërkesë elektronike për mbështetje financiare me të dhëna përkatëse dhe të bashkëngjisin dokumente elektronike të detyrueshme (1) Marrëveshje për kredi të lidhur me bankën ose shtëpinë e kursimeve për investimin e financuar nga Instrumenti për ndihmë paraqasëse në bujqësi dhe zhvillim rural nga Unioni Evropian dhe (2) Plan i detajuar i amortizimit i cili është shtesë i marrëveshjes për kredi.

- Kërkesat të cilat i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 2 do të radhiten sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk
- Kërkesat të cilat nuk janë parashtruar në mënyrë elektronike nuk do të mbikëqyren.

V. TËRHEQJE TË FORMULARËVE DHE UDHËZIME

Udhëzimet për regjistrim të kërkesve në sistemin për parashtrim elektronik të kërkesës mund të merren në faqen fillestare e-baranje.ipardpa.gov.mk. Udhëzimi për shfrytëzuesit e masës individuale mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masë.

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
Rr. " 3-ta Makedonska brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak bllok C)
1000 Shkup

VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesa e plotësuar elektronike për mbështetje financiare është e nevojshme të shkarkohet, printohet dhe nënshkruhet dhe së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të parashtrimit deri te Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në zarf të mbyllur në të cilin në anën e përparme në këndin e lartë të majtë qëndron **Kërkesë për mbështetje financiare dhe Numri arkivor i Kërkesës (1018-216-XXXX/1)**. Kërkesa mund të parashtrohet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë.

Afati përfundimtar për parashtrim të kërkesave është 18.01.2019.

Informata më të hollëshme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën:

e-baranje@ipardpa.gov.mk dhe ne ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural, Sektori për miratim të projekteve

Telefon 02 3097 - 460, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 16:30